



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 53/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) në Prishtinë, paraqitur kundër Kryeministrit të Kosovës Hashim Thaqi, i cili po ashtu është edhe Kryetar i subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në Prishtinë, për shkak të publikimit të një postimi në të cilin është paralajmëruar një video me material i cili do të transmetohet në TV publike dhe private, më elemente garuese të Zgjedhjeve të Përgjithshme që do të mbahen më 08.06.2014, duke e shfrytëzuar pozitën publike, në seancën e panelit të mbajtur me 12.05.2014, mori këtë:

## V E N D I M

**HIDHET** poshtë si e palejuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosja (LVV).

### Arsyetim

Me datën 09.05.2012, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga LVV, në të cilën pretendon se kryeministri i Kosovës Hashim Thaqi, ka publikuar një postim përmes TV publike dhe private ku shihet kryeministri i Kosovës duke bërë incizimin në hapësirat e objektit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, duke i bërë thirrje qytetarëve që ta ndjekin mesazhin e tij për mision të ri që i pret nga data 08 qershor 2014 dhe duke kërkuar që të ndiqet në orën 20:00 në televizionet RTK, Klan Kosova, RTV 21 dhe në Rrokum TV. Parashtruesi i ankesës thekson se vet fakti që video është incizuar në hapësirat e objektit të Qeverisë së Kosovës konsideron se me këtë rast është bërë cenimi i Kodit të Mirësjelljes së subjekteve politike konkretisht neni 35 i LZP-së dhe neni 6.1 të Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2013 të KQZ-së.

Neni 33 dhe 44 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), Rregulla Zgjedhore Nr. 11/2013, *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët* dhe Rregulla Zgjedhore Nr. 13/2013 *Fushata e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike*, përcaktojnë aktivitetet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, siç del nga të gjitha dispozita ligjore dhe Rregullat Zgjedhore të lartcekura, ndalojnë veprimet e subjekteve politike, shërbyesit publik, mbështetësit e tyre ose kandidatët e tyre gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës gjeti se:

## **ankesa është e palejuar**

Pretendimet ankimore së personi në fjalë e ka shfrytëzuar pozitën publike duke i bërë incizimet në objektin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me elemente garuese për zgjedhjet e përgjithshme që do të mbahen më 08.06.2014, të cilat incizime sipas parashtruesit të ankesës janë rënë ndesh më nenin 35 par. 1 të LZP-së. PZAP-i konstaton se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë ngase periudha e fushatës zgjedhore e përcaktuar nga KQZ-ja fillon nga data 28.05.2014 deri me datë 06.06.2014. Në KREUN -V- të LZP-së më dispozita përkatëse është paraparë KODI I MIRËSJELLJES PËR SUBJEKTET POLITIKE, MBËSHTETËSIT E TYRE DHE KANDIDATËT, i cili kod i mirësjelljes është i zbatueshëm nga fillimi zyrtar i fushatës zgjedhore. Nga kjo del se me asnjë dispozitë të paraparë të LZP-së dhe as me Rregullat Zgjedhore nuk është paraparë sanksionimi apo marrja e masave tjera ndëshkimore ligjore, para datës së përcaktuar për mbajtjen e fushatës zgjedhore.

Nga te cekurat më lart e duke u bazuar, në KREUN -V-, neni 31 dhe neni 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 53/2014 më datën 12.05.2014



PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*